

37.091.2:316.77

Mr.sc. Rexhep Dauti¹

KOMUNIKIMI SI FAKTOR I MOTIVIMIT TË MËSIMDHËNËSIT

КОМУНИКАЦИЈАТА КАКО ФАКТОР НА МОТИВАЦИЈА НА НАСТАВНИКОТ

COMMUNICATION AS A FACTOR OF MOTIVATION OF TEACHERS

Abstract

Big changes that have happened with the means of communication and exchange of information nowadays have increased the role and importance of the influx of information and communication speed on increasing the effectiveness of school management and thus the educational process. Achieving success in school, nowadays, significantly depends from communication skills to teachers inside and outside the school. Regardless, if it is about process of teaching and learning or for interpersonal relations in the school environment, success or failure is directly linked with the skills to communicate.

Keywords: teacher, communication, motivation, school, education

Abstrakt

Ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur me mjetet e komunikimit e të shkëmbimit të informacioneve në ditët e sotme kanë shtuar shumë rolin dhe rëndësinë që ka fluksi i informacioneve dhe shpejtësia e komunikimit në rritjen e efektivitetit të menaxhimit të shkollave dhe me këtë edhe të procesit edukativ dhe arsimor. Arritja e suksesit në shkollë, në ditët tona, varet në mënyrë të ndjeshme nga aftësitë komunikuese me mësimdhënësit brenda dhe jashtë shkollës. Pavarësisht, nëse bëhet fjalë për procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit apo për raportet ndërnjerezore në mjedisin shkollor, sukcesi ose dështimi ka lidhje direkte me aftësitë për të komunikuar.

Fjalë kyçe: mësimdhënësi, komunikimi, motivimi, shkolla, arsimi

¹ Magjistër i pedagogjisë, Sh. F. “Faik Konica” – Dobrosht, Maqedoni.
dautir@hotmail.com

Hyrje

Komunikimi është veprimtaria e shkëmbimit të informacionit kur marrësi e kupton dërguesin. Komunikimi mund të përkufizohet si mjeti me anën e të cilit individët arrijnë të shkëmbejnë midis tyre informacionet për operacionet dhe veprimtaritë që realizohen në një organizatë ose është një proces nëpërmjet të cilit mendimi krijohet dhe dërgohet për të krijuar kuptueshmërinë e gjërave.

Për rëndësinë dhe rolin e komunikimit kanë shkruar shumë autorë të njohur e të ndryshëm. Kështu për shembull, Chester I. Barnard thekson se: “Komunikimi duhet të zërë një vend qendror në teorinë e organizimit për shkak se struktura, gjerësia e shtrirjes dhe fushat e organizimit përcaktohen pothuajse tërësisht nga teknikat e komunikimit”. Gjithashtu sipas tij, funksioni kryesor i një ekzekutivi është ndërtimi dhe mbajtja e një sistemi të caktuar dhe efikas të komunikimit. Komunikimi shërben si një mjet i rëndësishëm, me anën e të cilit shkolla lidhet edhe me mjedisin e jashtëm. Komunikimi edhe pse nuk përfaqëson veprimtari të dukshme të rëndësishme të shkollës, ai luan rolin e gjatuk që i jep jetë dhe e bën shkollën të ekzistojë.

Arritja e suksesit në shkollë, në ditët tona, varet në mënyrë të ndjeshme nga aftësitë komunikuese me mësimdhënësit brenda dhe jashtë shkollës. Pavarësisht, nëse bëhet fjalë për procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit apo për raportet ndërnjerëzore në mjedisin shkollor, sukcesi ose dështimi ka lidhje direkte me aftësitë për të komunikuar.² Në fakt, komunikimi konsiderohet efektiv vetëm kur të tjerët e kuptojnë mesazhin tuaj në mënyre korrekte dhe ju përgjigjeni në mënyrën e duhur.

Komunikimi – faktor motivues

Komunikimi efektiv ndodhet në qendër të pothuajse çdo aspekti të veprimtarisë së shkollës dhe arsimitarit sepse lidh shkollën me të gjithë faktorët e rëndësishëm si mësimdhënësit, prindërit, komunitetin përreth etj. Nëse duhet përmirësuar efikasiteti, cilësia apo inovacioni, për këtë nevojiten aftësi të larta komunikuese. Ndryshimet e mëdha, që kanë ndodhur me mjetet e komunikimit e të shkëmbimit të informacioneve në ditët e sotme kanë shtuar shumë rolin dhe rëndësinë që ka fluksi i informacioneve dhe shpejtësia e komunikimit të tij në rritjen e

² Karaj, Th. & Tamo, A., Th. Psikologjia, tekstmësimorpërshkollën e mesmetëprofilizuar, profilishoqëror, Tiranë, SHBLSH, 2003, fq. 156,

efektivitetit të menaxhimit të shkollave dhe me këtë edhe të procesit edukativ dhe arsimor.

Për realizimin e një lëvizje të shpejtë dhe efektive të informacionit të domosdoshëm, udhëheqësit e shkollave qysh në momentin e projektimit organizativ duhet të mbajnë parasysh komunikimin, i cili do të realizohet në katër drejtime të ndryshme: komunikim nga lartë-poshtë, komunikim nga poshtë-lartë, komunikim horizontal dhe komunikim diagonal. Pra, marrja e informacionit për një diapazon të gjerë çështjesh që preokupojnë, jo vetëm mësime të mësimdhënësve, por edhe drejtuesit e tyre, i ndihmon këta të fundit që të përcaktojnë vendime sa më efektive qoftë për të zgjidhur një problem të dhënë, por po ashtu edhe për të eliminuar rezistencën e stafit të mësime të mësimdhënësve për ndryshimin e politikës udhëheqëse në lidhje me çështje të procesit mësimor dhe çështje të tjera të shkollës.

Përvoja ka treguar se në ato shkolla ku komunikimi vertikal poshtë-lartë mungon, apo nuk funksionon ashtu siç duhet, problemet janë më të mëdha pasi mësime të mësimdhënësve e ndejnë veten të mënjanuar nga çështjet që përcaktojnë organizatën, ndërsa distanca midis tyre dhe drejtuesve është e madhe sepse drejtuesi ose refuzojnë të dëgjojnë mësime të mësimdhënësve ose kanë kontakte jo të mjaftueshme me ta. Komunikimi horizontal si fluksi i informacionit ndërmjet individëve të cilët ndodhen në të njëjtin nivel hierarkik në shkollë, është i rëndësishëm jo vetëm për drejtuesit, por edhe për punëtorët e tjerë. Pa këtë lloj komunikimi nuk mund të realizohet koordinimi i funksionimit të aktivitetit edukativ dhe arsimor në shkollë.

Për mësime të mësimdhënësve, të cilët punojnë bashkërisht dhe komunikojnë rregullisht me njëri-tjetrin, rrallëherë mund të ndodhë që të ketë probleme të mirëkuptimit midis tyre. Ndërveprimi u jep atyre gjithashtu, mbështetje emocionale dhe i ndihmon për të kënaqur nevojat e tyre të komunikimit social dhe në grup.

Shpeshherë drejtuesit pohojnë se pengesat në komunikim janë një nga problemet më serioze me të cilat ata ndeshen në praktikë. Pengesat e komunikimit në mjaft raste shërbejnë për të paralajmëruar ekzistencën e problemeve më të thella, prandaj një drejtues shkolle nuk duhet t'i marrë gjërat shumë sipërfaqësore, por duhet që ta trajtojë çështjen në mënyrë më të detajuar për të zbuluar shkaqet e vërteta të barrierave të komunikimit.³ Drejtuesit duhet t'i njohin mirë barrierat që pengojnë

³ Orhani Z., "Motivacioni", Panteon, Tiranë, 2000, f.192,

gjatë komunikimit: Mungesa dhe mangësitë e planifikimit, problemet semantike dhe gjuhësore, interpretimet e ndryshme të informacionit është një pengesë tjetër kryesore në komunikim ku informacioni shpërndahet në individë të ndryshëm, shkalla e të dëgjuarit, informacionet e tepërta.⁴

Shumica e shkollave bëjnë përpjekje për të siguruar sjelljet etike dhe për rrjedhojë komunikimin e moralshëm nëpërmjet përpunimit dhe shpalljes të detyrueshme të rregullave të punës. Megjithatë, kyçe për zhvillimin e komunikimit etik në shkollë mbeten sjelljet individuale të drejtuesve dhe mbikëqyrësve. Në radhë të parë një drejtues duhet të diskutojë vazhdimisht lidhur me komunikimin etik në shkollën kua ai drejton. Kjo do të thotë se mënyra e përcaktuar e komunikimit duhet që të rishikohet herë pas here, për t'u sjellë në pajtim me stadin e zhvillimit moral dhe të nevojave aktuale të shoqërisë. Rishikimi i mënyrave të komunikimit, si një teknikë e përdorur këto vitet e fundit, është një metodë efikase për të kontrolluar politikat e komunikimit, procedurat, rrjetin dhe tërë aktivitetet e tij.

Gjuha e ndërlikuar renditet si një ndër problemet më serioze të komunikimit efektiv. Në një komunikim etik, që bazohet në kodet e përpunuara të etikës, në rregullat e adoptuara, apo në kuadron tjetër të pranuar, ka rëndësi gjithashtu, që të zgjidhet forma e dhënies së informacionit. A duhet që ky informacion të jepet në mënyrë të drejtpërdrejt, me gojë (në telefon, etj.) apo me shkrim (letra, libra, gazeta, reklama, etj.). Pra rëndësia e një komunikimi efektiv në shkollë lidhet ngushtë me përpunimin e gjykimeve etike dhe me vendimmarrjen, e cila duhet të jete moralisht e drejtë. Kështu një nga detyrat thelbësore profesionale të mësimit është organizimi i bashkëpunimit të mësimit me prindërit e nxënësve që ata të plotësojnë veprimtarinë pedagogjike, duke krijuar një formë të caktuar të ndikimit prindëror. Në sistemin e marrëdhënieve “mësimit dhe prindërit janë pjesëmarrës”, mësimit tërhiqet nga domosdoshmëria objektive dhe nga vetë kushtet e realizimit të procesit pedagogjik. Ky sistem marrëdhëniesh është i aftë të funksionojë edhe pa kontakt të drejtpërdrejt të pjesëmarrjes së tyre, pasi ata i lidh nxënësi si objekt i ndikimit të përbashkët.

Është gjithmonë e rëndësishme ura e komunikimit mësimit – prind, ndaj është evidente edhe kërkesa e kontakteve me prindërit e nxënësve dhe ndjenja e përgjegjësisë për organizimin e këtij

⁴ Koxhaj A. & Tomini F “Manaxhimi i komunikimit”, Afërdita, Tiranë, 2003, f.330,

bashkëpunimi. Tashmë është nënvizuar se prindërit e nxënësve dhe mësimit janë dy anë të përgjegjësive së përbashkët në edukimin e fëmijës përpara shoqërisë. Dobia pedagogjike e kësaj kërkese bazohet në domosdoshmërinë e integritit dhe gjithëpërfshirjes të gjithanshme të fëmijës dhe të treguesve të tij.⁵ Kontaktet e mësimit me prindërit e nxënësve duhet të kenë një karakter të vazhdueshëm.

Prindërit edhe mund edhe të gabojnë, mund të bëjnë një veprim jopedagogjik, por mësimit me bashkëpunimin e tij dhe krijimin e kushteve të favorshme ndihmon në zhvillimin e kulturës pedagogjike të prindërve dhe ndihmon të shpjegojë paditurinë pedagogjike në marrëdhënie me fëmijët. Mësimit nuk duhet të verë detyra para prindërve, pasi kështu ai nënshkruan pafuqinë e tij pedagogjike dhe mosdashjen për të mbajtur përgjegjësi për nxënësit. Por kjo nuk do të thotë që me takt dhe me etikë mësimit nuk duhet t'i bëjë të vetëdijshëm prindërit për dobinë që kërkesat e tyre të jenë unike në edukimin e fëmijëve.

Problemi i bashkëpunimit të mësimit me nxënësit në dritën e teorisë praktike komunikative, metodat e zhvillimit të kompetencave komunikative në procesin e komunikimit, teknika e komunikimit pedagogjik kanë nevojë për një përpunim shtesë, si në nivel të ndërtimit teorik përgjithësues, ashtu edhe në nivel rekomandimesh teoriko-praktike.⁶

Pedagogjia është një sferë e veprimtarisë njerëzore e cila karakterizohet nga përgjegjësia në rritje e mësimit për kulturën e të folurit. Kultura e komunikimit të mësimit ka specifikën e vet dhe duhet të jetë e formuluar në mënyrë të përcaktuar. Mësimit është një figure publike dhe e folura e tij profesionale është e lidhur ngushtë me etikën dhe retorikën e tij pedagogjike. Në thelb mësimit është personalitet krijues, me vlera dhe i orientuar, i aftë vazhdimisht për të ndryshuar dhe për t'u përsosur. Zotërimi i suksesshëm i profesionit pedagogjik nuk mundet pa zotërimin e të folurit kulturor dhe komunikimit kulturor. Kultura e komunikimit të mësimit është e bazuar, përcakton potencialin e gjithë sistemit të arsimit, masën e

⁵ Sadker, M.P. & Sadker, D.M, Teachers, School and Society (Mësuesi, shkolla, shoqëria), Tiranë, Eureka, 1995, f. 24.

⁶ Sadker, M.P. & Sadker, D.M, Teachers, School and Society (Mësuesi, shkolla, shoqëria), Tiranë, Eureka, 1995, f. 25.

ndikimit të saj në zhvillimin e personalitetit të nxënësit.⁷Përmbajtja e veprimtarisë profesionale të mësimit është paraqet para tij një numër kërkesash specifike që e detyron atë të zhvillojë cilësi personale të përcaktuara si të rëndësishme, të domosdoshme dhe të nevojshme profesionalisht.

Në veprimtarinë e përditshme edukative dhe arsimore ne shpesh pohojmë se mësimit është edhe shkencë edhe art. Po ç'është në radhë të parë mësimit? Duhet pohuar me plot gojë se mësimit është komunikim etik i institucionalizuar. Pra ndryshe nga komunikimi i zakonshëm, shpesh spontan dhe i paorganizuar, komunikimi në klasë është i drejtuar, i programuar dhe organizuar dhe pavarësisht prej formave të tij, verbale apo joverbale, gojore ose të shkruara, ai është në thelb i njëjtë. Natyrisht performanca e mësimit dhe e shkollës si dhe klima e klasës mund të sjellë prurje të reja, që duken se dalin jashtë planifikimit paraprak të orës së mësimit, por pavarësisht prej saj, edhe kur flasin edhe kur dëgjojnë, edhe kur evokojnë njohuri, edhe kur realizojnë kuptime apo zhvillojnë refleksione, partnerët në komunikim, mësimit dhe nxënësit, hyjnë në një proces të gjallë ku shkëmbehen ide dhe mesazhe, vështrime dhe sinjale, shenja dhe gjeste shpesh simbolike dhe metaforike, por gjithsesi shprehëse dhe mbresëlënëse. “Sapo fillon komunikimi, të dyja palët e ndiejnë se brenda tyre dhe midis tyre diçka lëviz. Është një lëvizje, që shpreh një gjendje të re psikike. E ndryshme nga gjendja psikike e mëparshme, kur palët nuk qenë të përfshira në komunikim me njëra-tjetrën.”⁸

Mësimit ka marrëdhënie të përditshme me njerëz të ndryshëm, kjo për arsye shtetërore apo private. Për të realizuar këto marrëdhënie, paraprakisht kërkohet një vlerësim racional, para se të komunikojë me një njeri i duhet të dijë:⁹

- Me cilin komunikon (subjekti),
- Përse komunikon (motivi, qëllimi, përfundimi),
- Për çfarë komunikon (konteksti ose brendia e komunikimit),
- Metoda e komunikimit, (përsëritje, rrëfim, bisedë, replikë),
- Sjellja gjatë komunikimit (etika , stili, takti),

⁷ Grup autorësh, “Strategjitë e të mësimit”- përvojë për një mësimit më të mirë, botimi i tretë - Teaching Strategies” Thrid Edition Toronto 1993, Eureka, Tiranë, 1995, f.179.

⁸ Çomo B., Psikologji komunikimi: refleksione dhe ligjërata, Tiranë. Pegi, 2001, f. 51.

⁹ Dedja, B. Sekretet e Talentit, traktat, Toena, Tiranë 1998, f. 167.

- Ku komunikohet (mjedisi, klasë, zyrë, sallë, rrugë, shtëpi),
- Ecurinë e komunikimit (normale, e qetë, e tensionuar, me rrjedha të qeta apo tensione emocionale) etj.

Komunikimi është një proces i imët, kompleks, por ai nuk mund të jetë një akt i thjeshtë, një proces me rrjedhje të qetë, pra me zhvillim horizontal, pasi brenda tij gjejmë ndërveprime në përputhje ose mos përputhje interesash me afrim dhe me shmangie, me mirëkuptim dhe keqkuptim, me konsensus dhe tolerancë, por dhe intolerancë.¹⁰ Për t'i shkuar më tej problemit të komunikimit duhet pasur parasysh, aftësia e të folurit, që në këtë mjedis, si tregues kryesor ka përdorimin e fjalëve të kuptueshme, shqiptimin e saktë, formulimin e pyetjeve të thjeshta, si dhe kthimin e përgjigjeve të qarta. Me vlerë është rritja e vëmendjes për të dëgjuar bashkëbiseduesin, për të kuptuar mirë problemin, për të dalluar opinionet nga faktet. Komunikimi, mënyra e të folurit nuk duhet të jetë e dhunshme që mund të shkaktojë shqetësime.

Ekzistojnë shumë shkaqe të gabimeve në komunikim, por më kryesoret janë:

- Kushtet objektive konkrete, mungesa e kapaciteteve në godinat shkollore, mjeteve dhe pajisjeve mësimore, teksteve dhe fletoreve, pra kaosi i një mjedisi, si dhe veprimtaria në zona të thella, ngarkesat e veta ekonomiko-sociale e psikologjike.
- Pamjaftueshmëria e dijeve dhe përvojës, veçanërisht vakumi i krijuar nga mosnjohjet e sferave afektive dhe motivacionale të veprimtarisë psikike, mungesat e përgjithshme në arsim dhe kualifikim e veçanërisht kur ai nuk ka përvojë.
- Niveli sot ende i papërsosur i shkencës pedagogjike e psikologjike dhe i modeleve, metodave dhe mjeteve diagnostikuese etj.

Por e rëndësishme është që gabimi të mos jetë si pasojë e pakujdesisë, nënvleftësimit, neglizhencës dhe veçanërisht mungesës së etikës profesionale.¹¹ Gabimi mund të ndodhë si në diagnostikimin e problemeve të komunikimit ashtu dhe në mjekimin e sëmundjes që mund të quhet braktisje pedagogjike. Gabimi diagnostik mund të vijë nga ecuria jo e zakonshme e komunikimit emocional, kur dihet se emocionet dhe motivacionet, ndryshe nga njohuritë kanë shenja atipike

¹⁰ Grup autorësh, “Studio gjithçka, arsyet vendin e parë”, AEDP, Tiranë, 1998, f. 384.

¹¹ Joyce, R. Bruce, Marsha, Weil & Calhoun, Emily: “Modele of Teaching” Modele të mësimdhënies, botimi i gjashtë, Allyn & Bacon, USA, Universiteti i Kalifornisë, botimi 7, 2007, f. 532.

ose mungesa në reagim. Gabimi i komunikimit dhe mungesa e suksesit në procesin mësimor edukativ vjen nga gabimi taktik i mësimdhënësit.

Shkollat të cilat mirë komunikojnë me mësimdhënësit janë shumë më funksionale, më tërheqëse dhe mbajnë për vete mësimdhënësit më të mirë dhe kështu bëjnë të kënaqur shfrytëzuesit e shërbimeve të tyre dhe forcojnë imazhin e vet. Pa udhëheqje strategjike të komunikimit me mësimdhënësit, rezultatet e punës pësojnë. Komunikimi me kolegët është forma më e rëndësishme e komunikimit në shkollë. Sot, pasi shkollat sa më shumë mbështeten në informacione dhe kalojnë nëpër ndryshime permanente, drejtuesit njohin nevojën e komunikimit me mësimdhënësit, por ende nuk janë të sigurt se si ta realizojnë, me qëllim të arritjes së rezultateve të matshme të shkollës.

Shkolla paraqet një tërësi resursesh, të cilën ndër të tjerat e përbëjnë edhe mësimdhënësit si resurse njerëzore. Specifika e resurseve njerëzore buron nga vet esenca e njeriut si qenie sociale, që është i detyruar të ketë raporte me të tjerë, si në punë ashtu edhe në jetë në përgjithësi. Pra, që mësimdhënësit në shkollë, si qenie sociale, të mund të japin kontributin e tyre maksimal në funksionimin e shkollës dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, është i nevojshëm një komunikim i mirë dhe para së gjithash i lirë. Drejtuesit të parët duhet të kuptojnë rëndësinë e komunikimit të mirë ndërmjet mësimdhënësve dhe pastaj këtë t'ua bëjnë të qartë edhe punonjësve të tjerë. Megjithatë, në shumë shkolla ende ekziston mënyra tradicionale e komunikimit ndërmjet drejtuesve dhe mësimdhënësve, që në të vërtetë edhe nuk nënkupton komunikim.¹² Në të vërtetë, në shkolla të tilla komunikimi zhvillohet duke dhënë urdhra drejtorit dhe duke dhënë raporte dhe përgjigje mësimdhënësi. Por, me komunikim në kushtet bashkëkohore nënkuptohet këmbim mendimesh dhe idesh ndërmjet mësimdhënësve, pa marrë parasysh nëse janë ata në pozitë më të ulët apo më të lartë me bashkëbiseduesin. Duke marrë parasysh se te mësimdhënësit më së shpeshti ekziston frikë për të shprehur mendimet dhe idetë, për shkak të kritikës eventuale ose përçmimit, drejtuesit duhet t'ua bëjnë me dije se çdo ide është e mirëseardhur dhe se të gjithë mësimdhënësit janë

¹² Kirby, Peggy C.; Louis V. Paradise; and Russell Protti. The Ethical Reasoning of School Administrators: The Principled Principal. (Arsyetimi Etik I Shkollës së Administratorëve: Parimet kryesore.) Paper presented at the annual meeting of the American Educational Research Association, Boston, April 1990. 11 pages. ED 320 – 253. (Studim i prezantuar në takimin vjetor të Shoqatës Amerikane të Studimeve për Edukimin), Boston, prill 1990. 11 faqe. ED 320 253.

bashkëbisedues të barabartë. Në këtë mënyrë ata stimulojnë komunikimin e lirë, pastaj edhe ndjenjën e përkatësisë së mësimdhënësit dhe motivimin e tyre më të madh për punë më cilësore në kryerjen e aktiviteteve edukative dhe arsimore. Pra, qëllimi është të sigurohet një udhëheqje me mësimdhënësit, përkatësisht orientim të tyre në një komunikim dykahësh, e jo në mënyrë tradicionale nëpërmjet urdhërimit dhe kontrollit rigoroz. Madje edhe kur udhëheqësit kontrollojnë mësimdhënësit në shkollën kua ata drejtojnë, qëllimi i kontrollit të tyre nuk guxon të jetë kërkimi i gabimeve për shkak të dënimit të mësimdhënësve, por zbulimi i gabimeve me qëllim të eliminimit të tyre në kohë dhe ndalimit dhe përhapjes së tyre. Prandaj udhëheqësit e shkollave, në rast të gjetjes së gabimeve të mësimdhënësit, nuk do të duhej të zbatonin dënim për to, por mënyrë se si t'u ndihmohet të ndreqin gabimet dhe sërish të mos përsëriten.

Komunikimi mundëson realizimin e aktiviteteve menaxhuese, krijon mundësi që të instalohen lidhje dhe relacione ndërmjet njerëzve, përkatësisht ndërmjet drejtuesve të shkollave dhe mësimdhënësve. Prandaj komunikimet paraqesin bazën e proceseve udhëheqëse në çdo shkollë, në çdo aktivitet dhe në çdo projekt me të cilin udhëhiqet.

Në shoqërinë tonë komunikimi luan një rol shumë të madh dhe kuptohet që është një nga elementet themelore në rritjen e efikasitetit të mësimdhënësit në punën e tij mësimore. Sa më të qarta, të kuptueshme dhe të specializuara dhe të strukturuar të jenë udhëzimet, aq më të lehtë e kanë mësimdhënësit për të kuptuar se çfarë u duhet të bëjnë dhe si të sillen në raport me aktivitetin arsimor që kërkohet nga ata. Sa më demokratik dhe liberal të jetë udhëheqësi i shkollës, aq më të lirë do të ndihen mësimdhënësit dhe motivimi i tyre do të jetë i madh dhe në të njëjtën kohë efikasiteti i punës së tyre do të rritet. Udhëheqësi i shkollës duhet të jetë në të njëjtën kohë edhe vizionar dhe të mos mendojë vetëm për të tashmen apo për një të ardhme të afërt por edhe për perspektivën e largët pasi kjo ndikon shumë në sigurinë dhe konformitetin e mësimdhënësve.

Përfundim

Pa dyshim se komunikimi i ndërsjellë i mësimdhënësve në kuadër të shkollës është një prej faktorëve kyç të krijimit të klimës punuese në shkollë. Komunikimi i mësimdhënësit me nxënësit dhe prindërit e tyre krijon lehtësira në efektshmërinë e punës së tij mësimore. Komunikimi me udhëheqësin e shkollës arsimtarëve u mundëson marrje më të lehtë

të informacioneve dhe transmetim më të lehtë të kërkesave lidhur me nevojat e tyre materiale dhe profesionale por edhe të natyrave të tjera. Pra, komunikimi i mirë i mësimdhënësit me këto faktorë që përbëjnë strukturën e “dukshme” të shkollës është një ndër faktorët më të rëndësishëm të motivimit të tij në punën e tij mësimore dhe në aktivitetin shkollor dhe jashtëshkollor që ka të bëjë me procesin edukativ dhe arsimor.

Conclusion

Undoubtedly, mutual communication of teachers within the school is one of the key factors to create the working climate in the school. Teacher communication with students and their parents facilitates the effectiveness of his teaching work. Communication with the school management, allows easier taking information by teachers and easier transmission of claims relating to their material and professional needs but also of other nature. Thus, good communication of teachers with these factors that constitute the "obvious" structure of the school is one of the most important factors motivating him in his teaching work and school and extracurricular activity that has to do with the educational process.

Literatura:

1. Kirby, Peggy C.; Louis V. Paradise; and Russell Protti. The Ethical Reasoning of School Administrators: The Principled Principal. Paper presented at the annual meeting of the American Educational Research Association, Boston, April 1990. 11 pages. ED 320 - 253.
2. Grup autorësh , “Studio gjithçka, arsyjes vendin e parë”, AEDP, Tiranë, 1998
3. Joyce, R. Bruce, Marsha, Weil & Calhoun, Emily: “Modele of Teaching” Modele të mësimdhënies, botim i gjashtë, Allyn & Bacon, USA, Universiteti i Kalifornisë, botimi 7, 2007
4. Grup autorësh, “Strategjitë e të mësuarit”- përvojë për një mësimdhënie më të mirë, botimi i tretë - Teaching Strategies” Thrid Edition Toronto 1993, Eureka, Tiranë, 1995
5. Çomo B., Psikologji komunikimi: refleksione dhe ligjërata, Tiranë. Pegi, 2001
6. Dedja, B. Sekretet e Talentit, traktat, Toena, Tiranë 1998
7. Sadker, M.P. & Sadker, D.M, Teachers, School and Society (Mësuesi, shkolla, shoqëria), Tiranë, Eureka, 1995

8. Koxhaj A. & Tomini F “Menaxhimi i komunikimit”, Afërdita, Tiranë, 2003
9. Orhani Z., “Motivacioni”, Panteon, Tiranë, 2000
10. Karaj, Th. & Tamo, A., Th. Psikologjia, tekst mësimor për shkollën e mesme të profilizuar, profili shoqëror, Tiranë, SHBLSH, 2003